

NEWSLETTER

Gusht



Për 7 mujorin e parë të 2024,
Albsig kryeson tregun e
Sigurimeve.

Apeli i Albsig: Bëni Sigurimin e
Shëndetit në udhëtim. Një
investim për ju dhe financat e
familjeve tuaja.

Albsig renditet në vendin e parë
për disa produkte kryesore të
sigurimeve.

Bli Online në Albsig:
Platforma e Sigurimeve online
që ju përgjigjet kërkesave të
shqiptarëve në kohë rekord.



PJESË E  KASTRATI GROUP

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 28 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.



Partneri juaj i sigurtë!



PJESË E  KASTRATI GROUP





Për 7 mujorin e parë të 2024, Albsig kryeson tregun e Sigurimeve

Vetëm në gjysmën e parë të këtij viti Albsig ka treguar një performancë të shkëlqyer, duke u pozicionuar si lider i padiskutueshëm në tregun e sigurimeve në Shqipëri për një numër të konsiderueshëm produktesh. Me një histori të gjatë dhe një përkushtim të palëkundur ndaj cilësisë dhe shërbimit ndaj klientit, Albsig ka arritur të ruajë dhe të forcojë pozitat e saj në disa nga segmentet më të rëndësishme të sigurimeve. Albsig ka treguar një performancë të fortë, të sigurtë dhe shumë premtuese përgjatë periudhës Janar-Korrik 2024 duke forcuar pozicionin e saj në tregun e sigurimeve në Shqipëri.

Kompania vazhdon të mbetet lider në sektorin e sigurimeve vullnetare, duke u dalluar për shpejtësinë e dëmshpërblimeve dhe përmirësimin e vazhdueshëm të produkteve dhe të shërbimeve. Për periudhën Janar — Korrik 2024 Albsig renditet në vend të 2-të me 19.08 % të tregut dhe me rritje me veten me rreth 2.08%. Ndërkaq, bazuar në statistikën e AMF, në sigurimin vullnetar Albsig po për periudhën Janar — Korrik 2024 është renditur në vend të 2-të dhe jo vetëm kaq por ka raportin më të lartë për sigurimet vullnetare me 55.45% ndërkohë që vetë tregu i sigurimeve e ka 36.67%. Ndërkaq bazuar në buletin statistikor të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare ndarja e tregut në Sigurimin e Zjarrit, Forcat e Natyrës dhe Dëmtimet e tjera në Pronë konkretisht për produktet (Zjarri, Vjedhja, Inxhinierike) për periudhën Janar - Korrik 2024, Albsig renditet sërish në vendin e 2-të duke zënë 24.56% të tregut.

Sipas statistikave të AMF-s, Albsig zë vendin e dytë edhe për sigurimin e sëmundjeve duke zënë 22.93%. Ndërkaq edhe për grupin e produkteve të sigurimit të aksidenteve dhe të shëndetit për periudhën Janar-Korrik 2024, Albsig renditet në vendin e dytë dhe zë 22.42%. Duke qenë edhe sezon turistik, edhe për këtë periudhë Albsig renditet në vend të dytë përsa i përket ndarjes së tregut në Sigurimin e Shëndetit në udhëtim.





Apeli i Albsig: Bëni Sigurimin e Shëndetit në udhëtim. Një investim për ju dhe financat e familjeve tuaja.

Udhëtimet, qofshin për arsye pune, pushime apo dhe vizita familjare janë pjesë e rëndësishme e jetës tonë. Megjithatë ashtu siç udhëtimet mund të jenë të këndshme por edhe të mbushura me përvoja të reja, ato mund të sjellin edhe rreziqe të papritura për shëndetin tuaj. Sigurimi i shëndetit në udhëtim është një mjet esencial për të mbrojtur veten dhe financat e familjes tuaj nga kostot e larta që mund të lindin në raste emergjencash mjekësore gjatë udhëtimit.

Sigurohu sot që të mbrohesh nga kostot e papritura nesër.

Sigurimi shëndetësor luan një rol kryesor në sigurimin e aksesit në kujdesin shëndetësor cilësor gjatë udhëtimit jashtë vendit. Në mjedise të panjohura, mund të jetë sfiduese të lundrosh në sistemet e kujdesit shëndetësor, të kuptosh objektet mjekësore ose të gjesh ofrues të kujdesit shëndetësor që flasin gjuhën tonë. Sigurimi shëndetësor ofron një rrjet sigurie, duke na mundësuar që të kërkojmë kujdes të menjëhershëm mjekësor dhe të marrim trajtimet e nevojshme pa u shqetësuar për kostot e tepruara ose pengesat gjuhësore. Urgjencat mjekësore mund të godasin papritur, duke prishur planet tona të udhëtimit dhe duke shkaktuar barrë të konsiderueshme financiare. Mbulimi i sigurimit shëndetësor siguron që ne të marrim menjëherë ndihmën e nevojshme duke eliminuar stresin e menaxhimit të shpenzimeve të paparashikuara mjekësore dhe duke na lejuar të fokusohemi në rikuperimin dhe mirëqenien. Një nga përfitimet kryesore të sigurimit të shëndetit në udhëtim është mbrojtja financiare ndaj kostove mjekësore që mund të lindin në rast sëmundjeje apo aksidenti jashtë vendit. Kujdesi shëndetësor në shumë vende mund të jetë i papërballueshëm dhe shumë i shtrenjtë dhe në mungesë të sigurimit mund të përballeni me një faturë të rëndë që mund të rëndojë ndjeshëm mbi buxhetin tuaj dhe të familjes. Me sigurimin e shëndetit në udhëtim, ju mund të udhëtoni me qetësi shpirtërore duke e ditur se jeni të mbuluar në rast se ndodh ndonjë e papritur. Ky sigurim përfshin shpesh edhe mbulimin e evakuimit mjekësor të personave të kudondodhur. Sigurimi i shëndetit në udhëtim është një investim i mençur që mund të mbrojë jo vetëm shëndetin tuaj por edhe stabilitetin financiar të familjes tuaj.

Investo sot që të kesh siguri nesër.

Përvoja e qetë dhe pa strese në udhëtim vjen nga siguria se jeni të mbuluar për çdo situatë që mund t'ju lind në çdo moment të paparashikuar. Mos e lini shëndetin dhe financat e familjes tuaj në rrezik, siguroni veten dhe familjen tuaj në çdo udhëtim. Ndërsa planifikojmë aventurat tona të udhëtimit, është thelbësore t'i japim përparësi shëndetit dhe mirëqenies sonë. Sigurimi shëndetësor shërben si një mjet jetik për të mbrojtur veten nga shpenzimet e papritura mjekësore dhe për të siguruar akses në shërbime cilësore të kujdesit shëndetësor gjatë eksplorimit të vendeve të ndryshme. Sigurimi i Shëndetit në Udhëtim vepron si një rrjet sigurie, duke na siguruar qetësi dhe duke na lejuar të përqendrohemi në gëzimin e udhëtimeve tona. Prandaj, përpara se të nisni ndonjë udhëtim, duhet të merrni mbulimin e duhur të sigurimit shëndetësor. Udhëtimi na ekspozon ndaj rreziqeve të ndryshme, duke përfshirë aksidente, lëndime, sëmundjet, apo edhe nevojën për evakuim mjekësor. Sigurimi i Shëndetit në Udhëtim kujdeset për këto nevoja të ndryshme, duke siguruar mbulim për të gjitha shpenzimet.

Albsig renditet në vendin e parë për disa produkte kryesore të sigurimeve.

Gjatë periudhës Janar-Korrik 2024, Albsig ka arritur rezultate të jashtëzakonshme duke u renditur në vendin e parë për disa nga produktet e saj kryesore në tregun e sigurimeve. Kompania ka forcuar pozicionin e saj si lider në disa segmente kyçe si sigurimi kasko, sigurimi i përgjegjësive dhe garancive. Për sigurimin Kasko Albsig ka ofruar zgjidhje të sofistikuara dhe të përshtatura për klientët, duke përmirësuar mbulimin dhe duke u siguruar që klienti të ketë mbështetje të plotë në rast dëmi. Ndërkaq, stafetën e vendit të parë Albsig e kryeson dhe në sigurimin kasko me 34.87% të tregut.

Përveç kësaj, sigurimi Kasko ka qenë një ndër produktet që Albsig ka vite që kryeson tregun duke ofruar mbulim të plotë ndaj rreziqeve të ndryshme që prekin automjetet. Bazuar në statistikën e AMF Albsig kryeson tregun me 36.77%, për Përgjegjësitë civile. Ndërkaq stafetën e vendit të parë Albsig e kryeson dhe në sigurimin kasko me 34.87% të tregut. Në vend të 1 Albsig kryeson tregun edhe për Përgjegjësinë e Ndertuesit duke zënë 53.86 % të tregut për periudhën Janar — Korrik 2024. Ndërkaq vlen për tu theksuar se edhe për garancitë albsig renditet në vendin e parë me 48.27% të tregut. Shpejtësia dhe efikasiteti në procesin e dëmshpërblimit janë arsye kryesore që kanë kontribuar në këtë sukses. Albsig vazhdon të jetë një partner i besueshëm për klientët e saj duke garantuar siguri dhe stabilitet financiar përmes produkteve të saj të sigurimit.

Gjatë këtyre gjashtë muajve të parë të vitit, Albsig vazhdon të zgjerojë ofertat e saj me mbi 35 produkte sigurimi që mbulojnë një gamë të gjërë nevojash, nga sigurimet e shendetit deri te ato të pronës, biznesit dhe përgjegjësive. Investimet e vazhdueshme në përmirësimin e shërbimeve dhe përvoja e gjatë në treg kanë kontribuar në ruajtjen e një reputacioni të lartë dhe besueshmërisë së kompanisë ndaj klientëve. Me një rrjet të gjerë degësh dhe agentësh, Albsig ka rritur të jetë pranë klientëve në çdo hap të procesit të sigurimit duke ofruar fleksibilitet dhe profesionalizëm në paketat e sigurimit sipas nevojave specifike të kërkuara nga vetë tregu.

Nuk duhet anashkaluar fakti se një nga faktorët kryesorë të suksesit të Albsig është aftësia e saj për të realizuar dëmshpërblimet në kohë rekord, aspekt ky që e ka diferencuar atë nga konkurrentet në treg. Kompania ka investuar vazhdimisht në teknologji dhe përmirësimin e proceseve duke garantuar që çdo kërkesë për dëmshpërblim të trajtohet me shpejtësi dhe profesionalizëm. Përmes rrjetit të saj të gjerë të degëve dhe agentëve në të gjithë territorin shqiptar, Albsig ka mundur një shërbim të afërt dhe të personalizuar për klientët e saj duke bërë të lehtë dhe të shpejtë çdo proces që lidhet me sigurimet. Kjo performancë lider shipi është një dëshmi e përkushtimit të Albsig për të qenë gjithmonë një hap përpara në tregun e sigurimeve.



ALBSIG

PJESË E



KASTRATI GROUP



Bli Online në Albsig

Platforma e Sigurimeve online që ju përgjigjet kërkesave të shqiptarëve në kohë rekord!

Në një kohë ku teknologjia po ndryshon rrënjësisht mënyrën se si i qasemi shërbimeve të përditshme, shqiptarët po përqafojnë gjithnjë e më shumë lehtësitë e platformës dixhitale për nevoja të ndryshme. Një nga fushat që po përjeton një rritje të shpejtë është blerja e sigurimeve online, dhe në këtë drejtim duket se Albsig ka dalë në pah si zgjedhja kryesore dhe alternativa më e mirë për konsumatorët.


Platforma Albsig Online, e krijuar për të lehtësuar procesin e marrjes së sigurimeve ka bërë të mundur që shqiptarët të blejnë siguracione në mënyrë të thjeshtë dhe të shpejtë, pa pasur nevojë të zënë radhat apo të vizitojnë fizikisht zyrat e kompanive të sigurimeve. Me një platformë miqësore dhe intuitive, Albsig u ofron përdoruesve të saj një eksperiencë të personalizuar ku ata mund të zgjedhin llojin e sigurimit që u përshtatet më së miri nevojave tyre, qoftë siguri i makinës, shëndetit, shtëpisë apo dhe i biznesit.

Çfarë e bën Albsig Online kaq tërheqëse?

Korrektësi, shpejtësi dhe thjeshtësi.

Blerja e siguracioneve përmes Albsig Online është një proces i drejtpërdrejtë dhe pa komplikime. Në vetëm disa hapa të thjeshtë përdoruesit mund të përfundojnë transaksionin e tyre dhe të sigurohen se po marrin mbulimin e duhur. Jo vetëm kaq, por platforma online e Albsig Online është një faqe shumë e thjeshtë e cila u mundëson përdoruesve të kryejnë veprime pa humbur aspak kohë dhe pa përjetuar strese. Konsumatorët mund të aksesojnë shërbimet nga çdo pajisje duke kursyer kohë dhe duke shmangur vizitat në zyrat fizike të kompanisë.

Platforma Online siguron informacione të qarta dhe transparente mbi produktet e sigurimit. Konsumatorët mund të krahasojnë opsionet e ndryshme të policave të sigurimit duke i ndihmuar ata të marrin vendime të informuara dhe të zgjedhin produktin që përputhet më mirë me nevojat e tyre. Me anë të Albsig Online, klientët mund të personalizojnë policat e tyre. Opsionet për konfigurimin e sigurimeve janë të qarta dhe të detajuara, duke i ofruar secilit klient një përvojë unike dhe të personalizuar.




Shpejtësia e procesimit të Kërkesave dhe Shërbim i Klientit në kohë reale.

Një nga avantazhet kryesore të platformës Albsig Online është shpejtësia e kryerjes së pagesave. Konsumatorët mund të bëjnë aplikime për sigurime dhe të marrin mmiratimin pothuajse në mënyrë të menjëherëshme, duke e bërë procesin shumë të shpejtë sesa në kanalet tradicionale të blerjeve. Albsig Online ofron shërbim të klientit në kohë reale përmes platformës saj online. Konsumatorët mund të kontaktojnë përfaqësuesit e kompanisë në çdo kohë për të marrë mbështetje apo për të zgjedhur ndonjë problematikë në mënyrë të shpejtë dhe efikase.

Siguri, besueshmëri, efikasitet oferta dhe promociione eskluzeve.

Platforma është e ndërtuar me teknologji të avancuar sigurie që garanton mbrojtjen e të dhënave personale dhe financiare të përdoruesve. Kjo siguri krijon besim dhe besnikëri tek konsumatorët. Një nga arsyet që konsumatorët përzgjedhin AlbsigOn është shkak i ofertave dhe promociioneve ekskluzive që shpesh janë të disponueshme vetëm për ata që përdorin platformën online. Këto veçori e bëjnë platformën e AlbsigOn jo vetëm tërheqëse, por edhe shumë praktike për konsumatorët modern që kërkojnë efikasitet dhe transparencë në shërbimet dhe produktet e sigurimeve.



 +355 (0) 42254770 / 764

 info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL